

KONTRATË SHKËMBIM KUOTASH

Nr: 6

Sot, në Tiranë, më date 30 Dhjetor 2025 (dymijë e njëzet e pesë) palët e mëposhtme nënshkruan kontratën që vijon:

- **Shoqëria KASTRATI sh.p.k** shoqëri e të drejtës shqiptare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë QKB në datë 11/04/2022 me numër të identifikimit të subjektit M21612025K dhe me adresë të ushtrimit të aktivitetit: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel Tirane, e përfaqësuar nga Administratorja: Znj. Tea Kashari, shtetase Shqiptar, lindur në Durrës, ne 12.04.1995 e banues ne Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë.
- **Z. Shefqet Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 05.06.1961, në Brrut, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër 034048371 dhe me nr. personal G10605213B.
- **Z. Shefit Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 22.07.1970, në Brrut, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës nr. personal H00722126W.
- **Z. Selam Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 18.11.1966, në Brrut, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës nr. personal G61118079C.
- **Z. Haredin Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 25.05.1973, në Brrut, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës i nr. personal H30525204K.
- **Z. Bilbil Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 04.08.1976, në Brrut, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës i nr. personal H60804113C.
- **Shoqëria "ALBANIA GAS TECH" SH.A.** shoqëri e të drejtës shqiptare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë QKB në datë 18-05-2011 me numër të identifikimit të subjektit L11718501C dhe me adresë të ushtrimit të aktivitetit: Fshati Pjeze Xhafzotaj Durres Shqipëri e përfaqësuar nga Administratori : Z.Selam Kastrati shtetas Shqiptar, lindur më 18.11.1966, në Brrut, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës nr. personal G61118079C.

(këtu e në vijim referuar si "Shkëmbyesit e Parë")


- **Shoqëria "JONUZ KASTRATI" sh.p.k** shoqëri e të drejtës shqiptare e regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB në datë 13/01/2025 me numër të identifikimit të subjektit M51313006D dhe me adresë të ushtrimit të aktivitetit: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel Tiranë, e përfaqësuar nga administratori: **Znj.Ina Alla** shtetase shqiptar, lindur më 30.05.1996, në Tiranë e banues në Tiranë, mbajtese e nr. Personal J65530054E madhore dhe me zotësi te plotë juridike per te vepruar.

(këtu e në vijim referuar si "Shkëmbyesi i Dytë")

(Në vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate z.Shefqet Kastrati, z.Shefit Kastrati, z. Selam Kastrati, z.Haredin Kastrati, z. Bilbil Kastrati, Shoqëria "ALBANIA GAS TECH" sh.a, Shoqëria "KASTRATI" sh.p.k dhe Shoqëria "JONUZ KASTRATI" sh.p.k të referohen veçmas si "Shkëmbyesi i Parë" dhe "Shkëmbyesi i Dytë" dhe së bashku si "Shkëmbyesit").

MEQËNËSE:

A. Shkëmbyesit e Parë janë aksionerë zotërues të kapitalit të shoqërisë "ALBANIA GAS TECH" sh.a, si në vijim:



"ALBANIA GAS TECH" SH.A.			
Vlera dhe zotërimi i kapitalit para shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve	% e zotërimit
JONUZ KASTRATI sh.p.k	13,174.5	66,065,064	50%
KASTRATI sh.p.k	8,563.4	42,942,292	32.5%
Shefit Kastrati	2,634.9	13,213,013	10%
Bilbil Kastrati	658.7	3,303,253	2.5%
Selam Kastrati	658.7	3,303,253	2.5%
Haredin Kastrati	658.7	3,303,253	2.5%
Shuma e kapitalit	26,349	132,130,128	100%

- B. Ortaku me 65% të kapitalit të shoqërisë "JONUZ KASTRATI" sh.p.k., është shoqëria "KASTRATI" sh.p.k e cila zotërohet 100% nga z.Shefqet Kastrati.
- C. Shkëmbyesi i Dytë Shoqëria "JONUZ KASTRATI" sh.p.k. është në pronësi 100% të:

"JONUZ KASTRATI" SH.P.K			
Vlera dhe zotërimi i kapitalit mbas shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr. i kuotave	Vlera e kuotave	% e zotërimit
KASTRATI sh.p.k	1	4,682,557,708	65%
Shefit Kastrati	1	1,440,786,987	20%
Bilbil Kastrati	1	360,196,747	5%
Selam Kastrati	1	360,196,747	5%
Haredin Kastrati	1	360,196,747	5%
Shuma e kapitalit	5	7,203,934,936	100%

- D. Shkëmbyesi i Parë po kryejnë një proces riorganizimi të entiteteve në pronësi të tyre (riorganizimi) për të optimizuar operacionet e tyre dhe për t'ju përgjigjur nevojave të zhvillimit strategjik të shoqërive.
- E. Fokusi strategjik i Shkëmbyesit të Parë përfshin, si dhe përmirësimin e efikasitetit operativ për të nxitur rritjen e investimeve afatgjatë dhe përfitimet për ortakët e saj.
- F. Si pjesë e riorganizimit, shkëmbyesi i Parë ka për qëllim të shkëmbejë kuotat në pronësi të kompanisë me Shkëmbyesin e Dytë, në shkëmbim të kuotave tek Shkëmbyesi i Dytë.
- G. Transaksionet e shkëmbimit të kuotave janë të parashikuara nga dispozitat e:
- Ligjit 9901/2008 "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregtare",
 - Ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe
 - Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 në zbatim të ligjit dhe në veçanti neni 46 "Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit".
- H. Organet kompetente të Shkëmbyesit të Parë, Shkëmbyesit të Dytë, kompanisë i kanë miratuar të gjitha rezolutat e nevojshme për aprovimin e këtij transaksioni për kuotat/aksionet.

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon;

Neni 1

OBJEKTI

1.1. Palët nëpërmjet kësaj kontrate shkëmbimi kuotash bëjnë kalim reciprok të pronësisë nëpërmjet shkëmbimit të kuotave pa kundërshtim midis tyre si më poshtë:

- **Shoqëria "KASTRATI" sh.p.k** Shkëmbyesi i Parë e shkëmben aksionet e zotëruar prej tij, me vlerë absolute dhe nominale prej 42,942,292 (dyzetë e dy milion e nëntëqindë e dyzetë e dy mijë e dyqind e nënëdhjetë e dy) lekë e cila përfaqëson 32.5% të kapitalit të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, të regjistruar pranë QKB me pjesën e rritur të kapitalit tek shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k**.
- **Shefit KASTRATI** Shkëmbyesi i Parë e shkëmben aksionet e zotëruar prej tij, me vlerë absolute dhe nominale prej 13,213,013 (trembëdhjetë milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e trembëdhjetë) lekë e cila përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, të regjistruar pranë QKB me pjesën e rritur të kapitalit tek shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k**.
- **Bilbil KASTRATI** Shkëmbyesi i Parë shkëmben aksionet e zotëruar prej tij, me vlerë absolute dhe nominale prej 3,303,253 (tre milion e treqindë e tre mijë e dyqindë e pesëdhjetë e tre) lekë e cila përfaqëson 2.5% të kapitalit të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, të regjistruar pranë QKB me pjesën e rritur të kapitalit tek shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k**.
- **Selam KASTRATI** Shkëmbyesi i Parë shkëmben aksionet e zotëruar prej tij, me vlerë absolute dhe nominale prej 3,303,253 (tre milion e treqindë e tre mijë e dyqindë e pesëdhjetë e tre) lekë e cila përfaqëson 2.5% të kapitalit të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, të regjistruar pranë QKB me pjesën e rritur të kapitalit tek shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k**.
- **Haredin KASTRATI** Shkëmbyesi i Parë shkëmben aksionet e zotëruar prej tij, me vlerë absolute dhe nominale prej 3,303,253 (tre milion e treqindë e tre mijë e dyqindë e pesëdhjetë e tre) lekë e cila përfaqëson 2.5% të kapitalit të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, të regjistruar pranë QKB me pjesën e rritur të kapitalit tek shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k**.
- Mbas këtij momenti shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k** bëhet ortak, zotërues i 100% të aksioneve të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, kurse shoqëria Kastrati sh.p.k, z. Shefit Kastrati, z. Bilbil Kastrati, z. Selam Kastrati dhe z. Haredin Kastrati përfitojnë pjesët respektive nga Shkëmbyesi i Dytë, shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k**. në rritjen e kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 66,065,064 (gjashtë dhjetë e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë.
- Shoqëria **"JONUZ KASTRATI" sh.p.k** Shkëmbyesi i Dytë, fiton pronësinë e 50% të aksioneve nga Shkëmbyesit e Parë tek shoqëria **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, me vlerë 66,065,064 (gjashtë dhjetë e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë **"ALBANIA GAS TECH" sh.a**, të zotëruar nga:

ALBANIA GAS TECH SH.A			
Vlera dhe zotërimi i kapitalit para shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr. i aksioneve	Vlera e kuotave	% e zotërimit
KASTRATI sh.p.k	8,563.4	42,942,292	32.5%
Shefit Kastrati	2,634.9	13,213,013	10%
Bilbil Kastrati	658.7	3,303,253	2.5%
Selam Kastrati	658.7	3,303,253	2.5%

Haredin Kastrati	658.7	3,303,253	2.5%
Shuma e kapitalit	13.174.5	66,065,064	50%

- Mbas kalimit të këtyre aksioneve në pronesi të shoqërisë "JONUZ KASTRATI" sh.p.k., shoqëria "KASTRATI" sh.p.k, z.Shefit Kastrati,z.Bilbil Kastrati,Z.Selam Kastrati,z.Haredin Kastrati nuk kanë më të drejta pronësie tek shoqëria "ALBANIA GAS TECH" sh.a, "

Neni 2:

DEKLARIMET DHE GARANCITE

- 2.1.** "Shkëmbyesi i Parë" deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate ai zotëron aksionet që do të transferohen sipas kësaj kontrate dhe ka të drejtën për ti transferuar nëpërmjet shkëmbimit këto aksione dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj kontrate nga ai nuk vjen në kundërshtim me ligjet, statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë "Shkëmbyesit".
- 2.2.** Pala "Shkëmbyesi i Dytë" deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate ka te drejta të plota për të pranuar shkëmbimin e aksioneve nga "Shkëmbyesi i Parë" sipas përcaktimeve të kësaj kontrate shkëmbimi dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj kontrate nga "Shkëmbyesi i dytë" nuk vjen në kundërshtim me ligjet, statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është ai.

Neni 3:

TRANSFERIMI I TE DREJTAVE MBI KUOTAT/AKSIONET

- 3.1.** Pronësia mbi 50% të vlerës së kapitalit të shkëmbyera të Shoqërisë "ALBANIA GAS TECH" sh.a., objekt i kësaj kontrate, kalon nga Shkëmbyesit e Parë tek Shkëmbyesi i Dytë menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.
- 3.2.** Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shkëmbyesit e Parë, shoqëria Kastrati sh.p.k, z.Shefit Kastrati,z.Bilbil Kastrati,Z.Selam Kastrati,z.Haredin Kastrati e humbasin të drejtën e vlerës së aksioneve e barabartë me 13,174.5 aksione dhe në vlerë 66,065,064 Lekë që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë "ALBANIA GAS TECH" sh.a
- 3.3.** Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shkëmbyesi i Dytë shoqëria "JONUZ KASTRATI" sh.p.k. fiton pronësinë mbi 50% të vlerës së aksioneve të shkëmbyesve të Parë, shoqërisë "KASTRATI" sh.p.k., z.Shefit Kastrati, z.Bilbil Kastrati, Z.Selam Kastrati, z.Haredin Kastrati dhe bëhet aksioner i shoqërisë "ALBANIA GAS TECH" sh.a., duke zotëruar 13,174.5 aksione me vlerë 66,065,064 Lekë që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 3.4.** Me nënshkrimin e kësaj kontrate shkëmbimi, pronësia mbi aksionet e shoqërisë "ALBANIA GAS TECH" sh.a., do të jene si në

ALBANIA GAS TECHSH.A			
Vlera e kapitalit dhe zotërimit të aksioneve mbas shkëmbimit			
Zotëruesi i kapitalit	Nr. i aksioneve	Vlera e kuotës	% e zotërimit
JONUZ KASTRATI SH.P.K	26,349	132,130,128	100%
Shuma e kapitalit	26.349	132,130,128	100%

Kalimi i pronësise së kapitalit të shoqërisë "ALBANIA GAS TECH" sh.a, në favor të shkëmbyesit të dytë do të rregjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin nr.9901/2008,të ndryshuar dhe ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

- 3.5.** Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shoqëria "JONUZ KASTRATI" sh.p.k, do të rrisë kapitalin e saj me vlerën e kuotës barabartë me 66,065,064 lekë.

Rritja e kapitalit të shoqërise "JONUZ KASTRATI" sh.p.k në favor të shkëmbyesve të parë do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin nr.9901/2008, të ndryshuar dhe ligjin 9723/2007, të ndryshuar. Mbas kësaj rritje vlere e kapitalit dhe zotërimi i kuotave të shoqëria "JONUZ KASTRATI" sh.p.k., do të bëhet si vijon:

JONUZ KASTRATI SH.P.K			
Vlera dhe zotërimi i kapitalit mbas shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr. i kuotave	Vlera e kuotave	% e zotërimit
Kastrati sh.p.k	1	4,725,500,000	65%
Shefit Kastrati	1	1,454,000,000	20%
Bilbil Kastrati	1	363,500,000	5%
Selam Kastrati	1	363,500,000	5%
Haredin Kastrati	1	363,500,000	5%
Shuma e kapitalit	5	7,270,000,000	100%

Neni 4

Zbatimi i kërkesave të Legjislacionit Fiskal

- 4.1. Ky transaksion i shkëmbimit të kuotave si më sipër është kryer në përputhje me kërkesat e dispozitave të:
- Ligjit 9901/2008 "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregtare,
 - Ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe
 - Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 në zbatim të ligjit dhe në veçanti neni 46 "Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit".
- 4.2. Nga shkëmbimi i kuotave nuk do të ketë asnjë pagesë në para për asnjë nga palët e përfshira në këtë shkëmbim.

Neni 5

Korrespondenca

- 5.1. Të gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera ndërmjet palëve duhet të bëhen vetëm me shkrim dhe të dërgohen pranë selisë së secilës palë, si më sipër përcaktuar.
- 5.2. Të gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera do të dërgohen me anë të letrës rekomande me kthim pergjigje ose me faks.
- 5.3. Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër do të konsiderohet i marrë efektivisht nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme: a) është dërguar me faks, në momentin në të cilin është marrë faksi; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 6.1. Palët angazhohen të zgjedhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e kësaj kontrate. Nëse një gjë e tillë nuk është me e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga gjykatat.

Neni 7

E drejta e zbatueshme

- 7.1. Kjo kontratë shkëmbimi kuotash do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. (çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo




lidhet me këtë kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 8


Vlefshmëria – Origjinalet


- 8.1. Kjo kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimet e saj nga Palët. Kjo Kontratë hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga Palët.
- 8.2. Kjo kontratë shkëmbimi kuotash, pasi u lexua nga Palët me zë të lartë e të qartë, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve dhe me firmosjen e saj merr fuqinë ligjore sipas ligjeve të përmendura më sipër me të gjithë efektet që sjell.


SHKËMBYESI I PARË Ortakët


Shefqet KASTRATI


Shefit KASTRATI



Selam KASTRATI


Haredin KASTRATI



Bilbil KASTRATI


SHKËMBYESI I DYTË Ortakët


Shefqet KASTRATI



Shefit KASTRATI


Selam KASTRATI



Haredin KASTRATI


Bilbil KASTRATI

SHKËMBYESI I PARË Administrator


Selam KASTRATI

SHKËMBYESI I DYTË Administrator


Ina ALLA

JONUZ KASTRATI SH.P.K.
NUI: M21612025K
TIRANE-ALBANIA

SHKËMBYESI I PARË Administrator


Tea KASHARI


KASTRATI Sh.p.k
NUI: M21612025K
TIRANA - ALBANIA